

## **PUNA E DOBISHME SHOQËRORE E NXËNËSVE:**

**Koncepti dhe udhëzimet për realizim**

## **PËRMBAJTJA**

|  |           |
|--|-----------|
| HYRJE.....   | 4         |
| Parimet e punës së dobishme shoqërore                                      |           |
| Qasjet në mësim  |           |
| <b>QËLLIMET E PUNËS SË DOBISHME SHOQËRORE.....</b>                         | <b>7</b>  |
| Lidhja me Konceptin për arsimin e mesëm gjimnaz                            |           |
| Rezultatet e pritshme  |           |
| <b>LLOJET E PUNËS SË DOBISHME SHOQËRORE.....</b>                           | <b>9</b>  |
| Ndihma dhe mbështetja në komunitet   |           |
| Fushata për rritjen të ndërgjegjësimit                                     |           |
| Përfaqësim për ndërmarrjen e veprimeve qytetare                            |           |
| Promovimi i multikulturalizmit dhe respektimi i diversitetit               |           |
| <b>KOMPONENTËT E PUNËS SË DOBISHME SHOQËRORE.....</b>                      | <b>10</b> |
| Mësim teorik (6 orë mësimore)  |           |
| Angazhim praktik (30 orë mësimore)   |           |
| <b>PËRGATITJET PËR ZBATIM .....</b>  | <b>11</b> |
| Përzgjedhja e mësuesve përgjegjës  |           |
| Përfshirja e komunitetit dhe prindërve/kujdestarëve                        |           |
| Formimi i grupeve të nxënësve për realizimin e punës së dobishme shoqërore |           |
| <b>UDHËZIMET PËR ZBATIM.....</b>   | <b>15</b> |
| Trajnime për mësim teorik (3 orë)  |           |
| Trajnime tematike (3 orë)  |           |

Planifikimi i projekteve (4 orë)

Zbatimi i projekteve (20 orë)

Reflektim mbi punën (2 orë)

Promovimi i projekteve (4 orë)

VLERËSIMI I NXËNËSVE.....18

SHTOJCAT .....20

Shembuj të projekteve

Formular për planifikim të projektit

## HYRJE

Në botën moderne, të rinjtë përballen me sfida të shumta sociale dhe humanitare që kërkojnë prej tyre ndërgjegjësim, empati dhe angazhim proaktiv. Kuptimin për këto sfida si dhe zhvillimin e ndjenjës për përgjegjësi sociale dhe qytetarisë aktive nxënësit e fitojnë përmes angazhimit të drejtpërdrejtë në punë të dobishme shoqërore. Përmes angazhimit në këtë punë, nxënësit në shkolla duhet të fitojnë njohuri, aftësi dhe përvoja që nevojiten për të mësuar se si të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit të tyre dhe më gjerë, në shoqëri.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në punë të dobishme shoqërore, nxënësit përfshihen në zgjidhjen e çështjeve nga bota reale, i kuptojnë këndvështrimet e ndryshme dhe bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët e tyre në projekte që rezultojnë nga nevojat e komunitetit dhe shoqërisë. Kjo punë nuk është vetëm përvojë edukative, por edhe platformë për zhvillimin personal, sepse u jep nxënësve mundësinë të mendojnë për rolin e tyre në botë dhe si mund të ndikojnë pozitivisht në gjetjen e zgjidhjeve për probleme të ndryshme sociale dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë të tjerët.

Në arsimin në gjimnaz, puna e dobishme shoqërore është e dedikuar për nxënësit e të gjitha viteve të shkollimit. Gjatë kësaj periudhe, të rinjtë zhvillojnë kompetencat e tyre personale, qytetare dhe profesionale, të menduarit kritik, përgjegjësinë shoqërore dhe gatishmërinë për të marrë pjesë aktive në komunitet.

Në këtë moshë, nxënësit janë të aftë për të menduarit kritik dhe janë gjithnjë e më të vetëdijshëm për çështjet shoqërore dhe humanitare që i rrethojnë. Nëpërmjet punës së dobishme shoqërore, ky ndërgjegjësim kanalizohet në veprime konstruktive, duke i kahëzuar nxënësit që të bëhen qytetarë të informuar dhe empatik.

Me përqendrimin në këtë grupmoshë dhe angazhimin në këtë lloj pune edukohet një gjeneratë e të rinjve që jo vetëm do të jenë të vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballen komunitetet e tyre, por edhe do të aftësohen për të ndërmarrë veprime. Pritet që ky angazhim i hershëm në punë të dobishme shoqërore t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë nevojë të përhershme për të dhënë kontribut pozitiv në shoqëri.

## Parimet e punës së dobishme shoqërore

### 1. Empatia dhe dhembshuria

Empatia përfshin të kuptuarit dhe ndarjen e ndjenjave të të tjerëve, ndërsa dhembshuria e zgjeron këtë kuptim të kujdesit aktiv dhe ndihmës për ata të cilët kanë nevojë. Zhvillimi i empatisë dhe dhembshurisë i ndihmon nxënësit të lidhen me njerëz me prejardhje të ndryshme në situata të ndryshme. I inkurajon të njohin problemet dhe nevojat e të tjerëve, duke nxitur ndjenjën e solidaritetit dhe përgjegjësie morale.

Aktivitetet që synojnë zhvillimin e empatisë dhe dhembshurisë të nxënësit mund të përfshijnë vullnetarizëm me grupe të ndryshme në komunitet, pjesëmarrje në aktivitete me lojë rolesh për të përjetuar këndvështrimet e të tjerëve, si dhe angazhim në projekte që ofrojnë

mbështetje të drejtpërdrejtë për individë të marginalizuar ose në pozitë të pafavorshme. Empatia dhe dhembshuria mund të zhvillohen, për shembull, përmes bashkëveprimit me të moshuarit në një institucion për përkujdesjen e personave të moshuar, duke u krijuar mundësinë nxënësve të dëgjojnë dhe të njihen me përvojat e tyre.

## **2. Gjithëpërfshirja dhe diversiteti**

Gjithëpërfshirja përfshin krijimin e mjedisit ku të gjithë, pavarësisht nga prejardhja, identiteti apo aftësitë e tyre, të ndjehen të respektuar dhe të vlerësuar. Diversiteti i referohet pranisë së dallimeve në një mjedis të caktuar, duke përfshirë përkatësinë etnike, gjinore, statusin socio-ekonomik etj. Pranimi i gjithëpërfshirjes dhe diversitetit siguron që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe kontribut, promovon mbështetjen e ndërsjellë, respektim dhe mirëkuptim midis nxënësve, përmirëson aftësitë sociale të nxënësve dhe zgjeron perspektivat e tyre. Vetëm kjo kontribuon në përgatitjen e nxënësve për të kontribuar në mënyrë aktive për jetën në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe multikulturore.

Puna e dobishme shoqërore mund të përfshijë aktivitete përmes të cilave kremtohen/shënohen kultura dhe tradita të ndryshme, siç janë panairët kulturore, punëtoritë për diversitetin dhe aktivitetet gjithëpërfshirëse për ndërtimin e ekipit. Përveç kësaj, aktivitetet që realizohen me grupe nxënësish të përziera në aspektin etnik/gjuhësor, pavarësisht nga përmbajtja apo qëllimi i tyre, mund të kontribuojnë në pranimin e diversitetit dhe në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës në një sistem arsimor që nuk është i segreguar mbi baza gjuhësore. Të gjitha aktivitetet në kuadër të punës së dobishme shoqërore duhet të mundësojnë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, pavarësisht nga aftësitë apo prejardhja e tyre.

## **3. Angazhimi në komunitet**

Angazhimi në komunitet përfshin ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të forta me shoqërinë lokale dhe organizatat për t'iu përgjigjur qëllimeve dhe sfidatve të përbashkëta. Duke u kyçur në komunitet, nxënësit mund të fitojnë përvojë prej botës reale dhe t'i kuptojnë më mirë problemet sociale. Kjo ndihmon në tejkalimin e hendekut midis përmbajtjes arsimore dhe zbatimit të tyre praktik, duke e bërë mësimin më relevant dhe më të pranueshëm.

Angazhimi në komunitet mund të arrihet përmes partneriteteve me organizatat lokale jofitimprurës/joqeveritare, projekteve të kryerjes së shërbimeve në komunitet dhe nismave të tjera për bashkëpunim.

## **4. Iniciativat e nxënësve**

Iniciativat e nxënësve kanë të bëjnë me fuqizimin e nxënësve për të propozuar dhe organizuar aktivitete, për të marrë vendime dhe për të pasur zë në mësimin e tyre dhe realizimin e aktiviteteve në projekte. Nxitja e iniciativave të nxënësve ndihmon në zhvillimin e aftësive drejtuese, komunikuese dhe organizative, vetëbesimin, ndjenjën e të poseduarit në punën e vet dhe ndjenjën e përkatësisë në shkollë dhe në shoqëri. Në të njëjtën kohë, realizimi i iniciativave të nxënësve promovon të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve, duke u mundësuar nxënësve të kenë rol aktiv në formësimin e përvojave të tyre arsimore.

Ofrimi i mundësive që nxënësit të udhëheqin projekte, të propozojnë ide dhe të marrin vendime për aktivitetet e tyre (p.sh. të vendosin se çfarë do të jetë fokusi në një projekt humanitar, si do të realizohen ngjarje të caktuara ose me kë do të bashkëpunojnë në fushatat

e përfaqësimit), e nxit pjesëmarrjen e tyre jo vetëm në projekte aktuale, por edhe në aktivitete të ngjashme në të ardhmen.

## 5. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria në këtë kontekst ka të bëjë me krijimin e projekteve dhe iniciativave që kanë ndikim pozitiv afatgjatë në shoqëri dhe mjedis, duke siguruar vazhdimsinë e efekteve edhe përtej kornizës kohore të caktuar. Theksimi i qëndrueshmërisë siguron që efektet pozitive të punës së dobishme shoqërore të zgjasin edhe pas përfundimit të aktiviteteve, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shoqërisë dhe ruajtjen e mjedisit.

Për të promovuar qëndrueshmërinë, projektet që në fillim duhet të hartohen për të ofruar përfitime afatgjata. Kjo mund të përfshijë krijimin e sistemeve për mbështetje të vazhdueshme, përdorimin e burimeve në mënyrë efikase dhe nxitjen e partneriteteve të cilat mund të mirëmbajnë dhe ta mbindërtojnë punën e nisur nga nxënësit. Shembuj të tillë janë projektet me ndihmën e të cilave rregullohen parqe dhe hapsira të gjelbërta në shoqëri që do të vazhdojnë t'i mirëmbajnë banorët vendas ose zhvillohen materiale edukative që shkollat do të mund t'i përdorin në vitet e ardhshme shkollore.

## Qasjet në mësim

Puna e dobishme shoqërore e nxënësve paraqet proces dinamik edukativ prej të cilit pritet që të ketë efekte pozitive tek nxënësit dhe në komunitet, përkatësisht në shoqëri. Për këtë qëllim, puna e dobishme shoqërore duhet të bashkojë qasjet e mëposhtme në të mësuar:

- **Të mësuarit përmes përvojës:**  
Nxënësit mësojnë më mirë kur marrin pjesë drejtpërdrejt në aktivitete dhe fitojnë përvoja reale dhe praktike prej tyre. Puna e dobishme shoqërore u mundëson nxënësve të përballen me situata konkrete, të mësojnë prej veprimeve të tyre dhe të zbatojnë njohuritë teorike në jetën reale. Nxënësit zhvillojnë nivel më të lartë empatie dhe përgjegjësie kur janë të përfshirë në aktivitete të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek të tjerët, veçanërisht kur ndihmojnë në komunitet.
- **Mësim i bazuar në projekte:**  
Kjo qasje i nxit nxënësit të lidhin dhe të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes disiplinave të ndryshme të përfaqësuar në mësimdhënien e rregullt për të zgjidhur një problem konkret ose për të përfunduar një projekt në fushën e punës së dobishme shoqërore. Duke zgjidhur probleme reale, nxënësit stimulohen të mendojnë në mënyrë kritike, të kërkojnë zgjidhje të ndryshme dhe të marrin vendime me rëndësi praktike.
- **Të mësuarit në bashkëpunim:**  
Puna e dobishme shoqërore përfshin më shumë pjesëmarrës, kështu që nxënësit zhvillojnë aftësi për punë ekipore, komunikim, negociim dhe vendimmarrje të përbashkët. Nxënësit mësojnë nga njëri-tjetri, gjë që pasuron procesin e tyre mësimor dhe i nxit ata të kuptojnë rëndësinë e mendimeve dhe përvojave të ndryshme. Këto kompetenca janë vendimtare për të ardhmen e tyre.

Këto tre qasje janë të ndërlidhura dhe së bashku formojnë një model arsimor dinamik dhe efikas, i cili jo vetëm përmirëson njohuritë akademike, por edhe ndërton aftësitë sociale, emocionale dhe komunikuese të nxënësve. Këto qasje nxisnin nxënësit të bëhen anëtarë aktivë të shoqërisë, të cilët mund të kontribuojnë në përparimin e saj.

## **QËLLIMET E PUNËS SË DOBISHME SHOQËRORE**

Puna e dobishme shoqërore duhet të kontribuoj në zhvillimin e ndërgjegjësimit, aftësive dhe përkushtimin e nxënësve për zgjidhjen e problemeve të karakterit socialo - humanitar. Qëllimet e kësaj lloji pune mund të shihen nga prizmi i Kornizës kombëtare të kompetencave kyçe dhe të operacionalizohen përmes rezultateve të pritura.

### **LIDHSHMËRIA ME KONCEPTIN PËR ARSIMIN E MESËM NË GJIMNAZ**

Puna e dobishme shoqërore është pjesë përbërëse e procesit edukativo-arsimor në arsimin e mesëm gjimnaz dhe kontribuon në realizimin e objektivave të përcaktuara në Konceptin për arsimin e mesëm në gjimnaz. Përmes përfshirjes aktive në aktivitete me interes për shkollën dhe komunitetin lokal, nxënësit zbatojnë njohuritë e fituara në situata reale jetësore, zhvillojnë përgjegjësi, iniciativë, bashkëpunim dhe të menduar kritik, ndërsa njëkohësisht nxitet zhvillimi i tyre personal, social dhe qytetar.

Puna e dobishme shoqërore kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e katër parimeve themelore të Konceptit për arsimin në gjimnaz:

#### **Zhvillimi i gjithanshëm i nxënësit**

Përmes planifikimit, organizimit dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme, nxënësit zhvillojnë aftësi të njohëse, sociale, emocionale dhe komunikuese, forcojnë vetëbesimin, përgjegjësinë dhe aftësinë për punë në ekip, si dhe zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues.

#### **Përgatitja për qytetari të përgjegjshme**

Duke marrë pjesë në aktivitete me interes për shkollën dhe komunitetin më të gjerë, nxënësit fitojnë përvoja në pjesëmarrjen aktive qytetare, zhvillojnë ndjenjën e solidaritetit, respektimin e të drejtave të njeriut, barazinë, gjithëpërfshirjen, vlerat demokratike dhe përgjegjësinë shoqërore.

#### **Zhvillimi i identitetit kulturor dhe kombëtar**

Përmes aktiviteteve të orientuara drejt ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, dialogut ndërkulturor, respektimit të dallimeve dhe bashkëpunimit në një mjedis multikulturor, nxënësit zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë, respektin reciprok dhe kohezionin shoqëror.

#### **Promovimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor**

Nxënësit përfshihen aktivisht në iniciativa ekologjike, aksione për rregullimin dhe mbrojtjen e mjedisit, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore, duke zhvilluar ndërgjegjësim ekologjik dhe qëndrim të përgjegjshëm ndaj natyrës.

#### **Lidhshmëria me Kornizën kombëtare të kompetencave kyçe**

Puna e dobishme shoqërore përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm për zhvillimin dhe zbatimin praktik të njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve të përcaktuara në Kornizën Kombëtare të Kompetencave kyçe për arsimin gjimnazor. Përmes aktiviteteve reale, nxënësit jo vetëm që thellojnë njohuritë e fituara, por edhe i zbatojnë ato në kontekste të ndryshme shoqërore, duke zhvilluar aftësi

për të mësuar në mënyrë të pavarur, për të bashkëpunuar, për të zgjidhur probleme, për të marrë iniciativa dhe për të marrë vendime me përgjegjësi.

| Elementi i Kornizës Kombëtare | Kontributi i punës së dobishme shoqërore   |
|-------------------------------|--|
| Njohuritë                     | Zbatimi i njohurive të fituara në situata reale, ndërlidhja e përmbajtjeve nga fusha të ndryshme mësimore dhe zhvillimi i një qasjeje ndërdisiplinore.         |
| Shkathtësitë                  | Zhvillimi i shkathtësive komunikuese, sociale, organizative dhe udhëheqëse, të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, puna në ekip dhe marrja e iniciativës. |
| Vlerat                        | Zhvillimi i solidaritetit, përgjegjësisë, respektimit të dallimeve, integritetit, veprimit etik dhe kujdesit për komunitetin.                                  |
| Qëndrimet                     | Nxitja e qytetarisë aktive, vullnetarizmit, sipërmarrësisë, përgjegjësisë mjedisore, respektimit të vlerave demokratike dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.    |

Në këtë mënyrë, puna e dobishme shoqërore nuk paraqet vetëm një aktivitet shtesë, por një instrument të rëndësishëm edukativo-arsimor, përmes të cilit nxënësit zhvillojnë kompetencat e nevojshme për vazhdimin me sukses të arsimit të lartë, zhvillimin personal, realizimin profesional dhe pjesëmarrjen aktive në një shoqëri demokratike dhe të përgjegjshme, që është një nga objektivat kryesore të Konceptit për Arsimin Gjimnazor.

## Rezultatet e pritshme

Puna e dobishme shoqërore duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të ketë efekte të shumëfishta në fusha të ndryshme të zhvillimit të nxënësve. Duke siguruar pjesëmarrjen aktive të nxënësve, pritet të arrihen rezultatet e mëposhtme:

- **Përmirësimi i ndërgjegjësimi social:** Nxënësit do të fitojnë njohuri më të thella të çështjeve sociale dhe humanitare, si: varfëria, pabarazia, qëndrueshmëria ekologjike, të drejtat e njeriut etj. Ata do të mësojnë të njohin ndërlidhjen e këtyre çështjeve dhe ndikimin që ato kanë tek individët dhe komunitetet.
- **Zhvillimi i empatisë dhe dhembshurisë:** Duke punuar në projekte të cilat kanë të bëjnë me problemet e botës reale, nxënësit do të zhvillojnë ndjenjë më të madhe empatie për ata që kanë nevojë. Ata do të mësojnë të vlerësojnë sfidat me të cilat përballen të tjerët dhe do të motivohen për të kontribuar në gjetjen e zgjidhjeve.
- **Forcimi i angazhimit civil:** Puna e dobishme shoqërore i nxit nxënësit të bëhen pjesëmarrës aktivë në komunitetet e tyre. Nëpërmjet realizimit të projekteve praktike në komunitetin e afërt dhe më të gjerë, nxënësit do të mësojnë për rëndësinë e përgjegjësisë civile dhe fuqinë e veprimit të përbashkët në krijimin e ndryshimeve pozitive.

- **Ndërtimi i punës në grup dhe aftësive udhëheqëse:** Nxënësit do të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët e tyre në projekte të ndryshme, duke ndërtuar/zhvilluar punën në grup, komunikimin dhe aftësitë udhëheqëse. Këto aftësi janë thelbësore jo vetëm për suksesin e projekteve, por edhe për jetën e ardhshme akademike dhe profesionale të nxënësve.
- **Nxitja e zhvillimit personal:** Pjesëmarrja në punën e dobishme shoqërore do të nxisë vetë-reflektimin dhe zhvillimin personal. Nxënësit do të inkurajohen të mendojnë në mënyrë kritike për vlerat e tyre dhe se si mund të kontribuojnë për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.

## LLOJET E PUNËS SË DOBISHME SHOQËRORE

Të gjitha llojet e punës së dobishme shoqërore duhet t'u mundësojnë nxënësve të bëjnë ndryshim të dukshëm në komunitetet e tyre. E përbashkët për të gjitha llojet e kësaj pune është se nxënësit janë të përfshirë si pjesëmarrës aktivë ndërsa mësimdhënësit janë vetëm drejtues në këtë proces. Të gjitha aktivitetet e ofruara në kuadër të llojeve të ndryshme të kësaj pune mundet dhe duhet t'u përshtaten nevojave, burimeve dhe interesave specifike të nxënësve, me kusht që të ruhet komponenti i tyre arsimor dhe të arrihen efektet e pritura.

Nxënësit mund të kryejnë lloje të ndryshme të punëve të dobishme shoqërore, të grupuara rreth katër kategorive të mëposhtme:

### Ndihma dhe mbështetja në komunitet

- **Rregullimi i hapësirave publike:** pastrimi i hapësirave publike (p.sh. parqe dhe rrugë, kënde lojërash), lyerja e gardheve etj.
- **Mbjellja e bimëve dhe zbulimi i mjedisit:** mbjellja e pemëve dhe gjelbërimi, rritja e luleve ose produkteve kopshtare, kositja e barit ose realizimi i aktiviteteve për ruajtjen e mjedisit.
- **Fushata për donacione:** grumbullimi dhe shpërndarja e ushqimeve, veshjeve dhe produkteve të tjera bazë për ata që kanë nevojë (për shembull, për strehimoret e të pastrehëve, për viktimat e fatkeqësive natyrore).
- **Vullnetarizmi në azile/qendra kujdesi:** dhënia e ndihmës në shtëpitë e të moshuarve, strehimoret e të pastrehëve, strehimoret e viktimave të dhunës, strehimoret e kafshëve etj.

### Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit

- **Edukim për shëndetin dhe mirëqenien:** realizimi i fushatave ndërgjegjësuese për sfidat shëndetësore si për shembull, shëndeti mendor, të ushqyerit dhe ushtrimet fizike.
- **Fushata kundër dhunës:** organizimi i seminareve për edukimin e bashkëmoshatarëve kushtuar ngacmimit dhe bullizmit dhe promovimit të kulturës së mirësjelljes dhe gjithëpërfshirjes.
- **Ndërgjegjësimi ekologjik:** organizimi i ngjarjeve ose krijimi i materialeve edukative për mbrojtjen e mjedisit, riciklimin dhe jetesa e qëndrueshme.
- **Përfaqësimi për të drejtat e njeriut:** kryerja e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, si barazia gjinore, mbështetja e refugjatëve ose drejtësia sociale.

## Përfaqësimi për ndërmarrjen e veprimeve qytetare

- **Përfaqësimi për zgjidhjen e problemeve:** identifikimi i problemeve që prekin nxënësit dhe përpjekja për aplikimin e ndryshimeve që çojnë në zgjidhjen e problemeve (për shembull, përmes peticioneve, shkrimit të letrave ose fushatave në mediat sociale).
- **Edukimi për kulturë demokratike:** organizimi i edukimit të bashkëmoshatarëve për të forcuar pjesëmarrjen demokratike të nxënësve në klasë dhe në komunitetet e nxënësve në shkollë.

## Promovimi i multikulturalizmit dhe respektimi i diversitetit

- **Panaire multikulturore:** organizimi i ngjarjeve që promovojnë identitetin kulturor të nxënësve përmes ushqimit, muzikës, vallëzimit dhe tregimit të tregimeve karakteristike për komunitetet etnike ose rajoneve në vend.
- **Punëtori multikulturore:** organizimi i punëtorive që hulumtojnë dhe festojnë kultura dhe identitete të ndryshme në komunitetin e shkollës.

Shembuj të projekteve nga lloje të ndryshme të punës së dobishme shoqërore janë dhënë në Shtojcën A. Të gjithë shembujt e përmendur aty synojnë të shërbejnë vetëm si frymëzim për projektet që do të zhvillohen për realizimin e punës së dobishme shoqërore.

## KOMPONENTËT E PUNËS SË DOBISHME SHOQËRORE

Puna e dobishme shoqërore duhet të strukturohet në mënyrë për t'u siguruar nxënësve kombinim të balancuar të njohurive teorike dhe përvojë praktike. Përbëhet nga disa komponentë që duhet të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të të kuptuarit të sfidave socialo-humanitare nga nxënësit dhe në angazhimin e tyre për tejkalimin e këtyre sfidave.

### Mësim teorik (6 orë mësimore)

Nxënësit njihen me punën e dobishme shoqërore përmes pjesëmarrjes në trajnime që duhet t'u ofroj nxënësve njohuritë e nevojshme për çështjet sociale dhe humanitare. Mësimi teorik, që zgjat 6 orë mësimore, zhvillohet përmes kombinimit të ligjeratave, diskutimeve dhe prezantimeve multimediale që përfshijnë:

- **Çështjet sociale globale dhe lokale:** zbulimi se cilat janë çështjet e rëndësishme sociale dhe humanitare në nivel global dhe lokal (p.sh., varfëria, pabarazia, sfidat ekologjike, të drejtat e njeriut).
- **Etika dhe përgjegjësia sociale:** diskutimet mbi implikimet etike të punës së dobishme shoqërore dhe përgjegjësitë e individëve dhe komuniteteve në promovimin e drejtësisë sociale.
- **Kompetenca kulturore:** të kuptuarit e rëndësisë së ndërgjegjësimit kulturor dhe ndjeshmërisë në punën e dobishme shoqërore, veçanërisht kur aktivitetet kanë të bëjnë me komunitete që janë të ndryshme nga ato të dikujt (p.sh., dallimet në gjuhë, fe, moshë).

## Angazhim praktik (30 orë mësimore)

Thelbi i programit është angazhimi praktik, në kuadër të të cilit nxënësit zbatojnë njohuritë e tyre duke punuar në projekte praktike në botën reale të punës së dobishme shoqërore. Ky komponent realizohet në fazat e mëposhtme:

- **Trajnimi tematik:** Organizohet me qëllim që nxënësit të fitojnë kompetenca specifike që nevojiten për realizimin me sukses të aktiviteteve në kuadër të projektit "të tyre". Kështu për shembull, nëse projekti ka të bëjë me organizimin e fushatave kundër dhunës, trajnimi duhet të jetë rreth asaj se si të zhvillohen fushata efektive, por edhe në lidhje me llojet e dhunës dhe si të trajtohen ato në kontekstin specifik dhe grupin e synuar konkret të fushatës. Ose, nëse nxënësit vendosin të zbatojnë punëtori multikulturore, trajnimi duhet t'u mundësojë nxënësve të fitojnë jo vetëm kompetenca multikulturore, por edhe kompetenca për të zhvilluar punëtori me grupin e synuar "të tyre".
- **Planifikimi i projektit:** Nxënësit punojnë në grupet e tyre për të planifikuar dhe hartuar aktivitetet në kuadër të projekteve të tyre. Prej tyre pritët që të identifikojnë çështje të caktuara, të vendosin qëllime dhe të zhvillojnë plan aksional të detajuar me aktivitete që do të kontribuojë në zgjidhjen e problemit. Mësimdhënësit japin udhëzime për të siguruar realizimin dhe efikasitetin e projekteve.
- **Zbatimi i projekteve:** Nxënësit i realizojnë aktivitetet në kuadër të projekteve të tyre sipas udhëzimeve që përmban plani i veprimt. Mësimdhënësit ndjekin angazhimin e tyre për tu siguruar që zbatimi i aktiviteteve është në rrugën e duhur dhe se qëllimi i vendosur do të arrihet në punën me grupet e synuara.
- **Reflektimi:** Gjatë dhe pas realizimit të projekteve, nxënësit ndajnë përvojat e tyre, sfidat me të cilat janë përballur dhe sukseset që kanë arritur. Kjo i lejon ata të përvetësojnë përvojat e tyre dhe t'i lidhin ato me çështje më të gjera sociale dhe humanitare.
- **Promovimi i projekteve:** Në një ngjarje të veçantë nxënësit prezantojnë para shkollës dhe komunitetit "produktet" nga realizimi i projekteve të tyre.

Për angazhimin praktik të nxënësve (të gjitha fazat së bashku) janë planifikuar 30 orë mësimore. Kohëzgjatja e secilës fazë, e shprehur në orë, mund të ndryshojë nga një projekt në tjetrin, në varësi të llojit të punës së dobishme shoqërore, përkatësisht nga natyra e aktiviteteve që pritët të realizohen.

## PËRGATITJET PËR ZBATIM

### Përzgjedhja e mësimdhënësve përgjegjës

Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë që do të përfshihen në realizimin e punës me dobi shoqërore caktohen nga shkolla, në përputhje me nevojat për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, numrin e grupeve të formuara të nxënësve dhe mundësitë kadrovike të shkollës. Realizimi i punës së dobishme shoqërore është pjesë e detyrimeve të punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, në kuadër të 40 orëve të punës në javë, në përputhje me Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme.

Në varësi të organizimit të punës, shkolla mund të caktojë mësimdhënës dhe/ose bashkëpunëtorë profesionalë që do ta realizojnë trajnimin hyrës (pjesën teorike), si dhe mësimdhënës që do të jenë

përgjegjës për mentorimin, koordinimin dhe monitorimin e nxënësve gjatë realizimit të aktiviteteve praktike. I njëjti mësimdhënës mund të angazhohet në të dy segmentet e realizimit, nëse kjo i përshtatet organizimit të shkollës.

Shpërndarja e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë sipas grupeve të nxënësve, dinamika e realizimit dhe koha e angazhimit të tyre planifikohen në kuadër të organizimit vjetor të punës së shkollës. Mësimdhënësi mund të jetë përgjegjës për një ose më shumë grupe nxënësish, në mënyrë të njëpasnjëshme ose paralele, varësisht nga numri i grupeve të formuara dhe organizimi i aktiviteteve, ndërsa të gjitha aktivitetet realizohen në kuadër të detyrimeve të tij të rregullta të punës.

Angazhimi i mësuesve përgjegjës për realizimin e punës së dobishme shoqërore k përfshin:

- **planifikimin e angazhimit të tyre** në kuadër të punës së dobishme shoqërore për secilin grup nxënësish veçmas, si dhe përshtatjen e nevojshme të planifikimit në përputhje me situatat e reja ose të paparashikuara. Planifikimi duhet të përmbajë: listën e nxënësve të përfshirë, llojin e punës së dobishme shoqërore dhe grupet e synuara që do të përfitojnë prej saj, periudhën kohore të realizimit, si dhe planin dhe instrumentet për monitorimin e rregullsisë së nxënësve, pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre në aktivitete;
- **sigurimi i një mjedisi gjithëpërfshirëse dhe të sigurt** për realizimin e aktiviteteve të projektit, si për nxënësit ashtu edhe për pjesëmarrësit nga grupi i synuar;
- **monitorimin e vazhdueshëm të punës së nxënësve**, në përputhje me rolin e tyre në zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit për realizimin e projektit, si dhe ofrimin e mbështetjes dhe ndihmës për tejkalimin e sfidave të mundshme, duke u dhënë njëkohësisht informatë kthyesë për arritjet e tyre gjatë gjithë procesit;
- **ndjekjen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve** gjatë zbatimit të të gjithë projektit.

## **Përfshirja e komunitetit dhe prindërve/kujdestarëve**

Në kontekst të punës së dobishme shoqërore të nxënësve, komuniteti i referohet një grupi njerëzish që jetojnë në të njëjtin mjedis dhe ndajnë interesa, vlera dhe qëllime të përbashkëta. Mund të jetë komunitet lokal, si vendbanim, qytet ose fshat, ose mund të jetë një komunitet më i ngushtë i lidhur me tema të caktuara sociale ose shoqërore (p.sh. fëmijët në kopsht, persona të vendosur në shtëpi për persona të moshuar, etj.). Kur nxënësit kryejnë punë të dobishme shoqërore për komunitetin, ata marrin pjesë në aktivitete që synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës në atë komunitet, të ndihmojnë grupet e cënueshme ose të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve sociale dhe humanitare. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, nxënësit zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, empatisë dhe ndërgjegjësimin për nevojat e të tjerëve.

Përfshirja e komunitetit në punën e dobishme shoqërore të nxënësve është çelësi për suksesin e punës së dobishme shoqërore të nxënësve. Përfshirja e tij në përgatitjen për punën e dobishme shoqërore është thelbësor për të siguruar rëndësinë dhe suksesin e aktiviteteve. Kjo mund të arrihet përmes:

- **identifikimit të nevojave të komunitetit:** zbatohet nga shkollat dhe/ose bashkësitë e nxënësve përmes anketave, intervistave ose bisedave me drejtues lokalë, ekspertë në fusha të caktuara,

organizatat dhe/ose institucionet lokale, me qëllim për të kuptuar më mirë nevojat e komunitetit dhe për të përcaktuar mundësitë për përfshirjen e nxënësve.

- **koordinimi me organizatat lokale:** komunat, institucionet publike dhe private dhe organizatat joqeveritare aktive në komunitet mund të bashkëpunojnë me shkollat për të ofruar projekte apo iniciativa konkrete dhe për t'u ofruar nxënësve platforma për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve reale sociale.
- **përfshirja e anëtarëve të komunitetit** drejtpërdrejt në punën e dobishme shoqërore të nxënësve si mentorë, koordinatorë ose vullnetarë (për shembull, banorët lokalë ose profesionistët mund të ndajnë përvojat e tyre ose, së bashku me Mësimdhënësit përgjegjës, t'i udhëheqin nxënësit në realizimin e aktiviteteve).
- **sigurimi i burimeve dhe mbështetjes nga komuniteti:** kyçja e bizneseve dhe organizatave lokale mund të sigurojë mbështetje financiare ose materiale për projekte (për shembull, bizneset lokale mund të sponsorizojnë aktivitete ose të ofrojnë bashkëpunim për projekte me interes për komunitetin).

Rekomandohet që në procesin e negocimit për përfshirjen e grupeve potenciale të synuara në punën e dobishme shoqërore të nxënësve të përfshihen prindërit/kujdestarët (nëpërmjet këshillave të prindërve dhe/ose individualisht) për shkak të kontributit që ata mund të japin në ofrimin e mbështetjes së komunitetit. Pritet që shkolla të informojë prindërit/kujdestarët për punën e dobishme shoqërore që planifikon dhe për pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve përgjegjës në realizimin e saj. Gjithashtu, shkolla mund të nxisë prindërit/kujdestarët që të marrin pjesë në aktivitete të caktuara të projekteve konkrete të planifikuara nga nxënësit.

Përveç kësaj, çdo nxënës duhet të marrë pëlqimin nga prindërit/kujdestarët për të marrë pjesë në punë konkrete të dobishme shoqërore, veçanërisht kur ai përfshin aktivitete që zhvillohen jashtë ambienteve të shkollës.

## **Formimi i grupeve të nxënësve për realizimin e punës së dobishme shoqërore**

Mësimdhënësit përgjegjës, të angazhuar për realizimin e punës së dobishme shoqërore, në bashkëpunim me komunitetin e nxënësve, zhvillojnë procedurën e zgjedhjes së llojit të punës së dobishme shoqërore me nxënësit sipas klasave - veçanërisht për nxënësit e vitit të parë, dytë dhe të tretë. Nxënësve u jepet listë me tre lloje të punës së dobishme shoqërore të ofruara për vitin shkollor (shembuj të dhënë në kapitullin Llojet e punës së dobishme shoqërore mund të shërbejnë si ide). Lista e llojeve të ofruara të punës së dobishme shoqërore bëhet në bazë të:

- nevojave të identifikuara të komunitetit
- ofertave nga komunitetet lokale
- rekomandimeve të marra nga nxënësit e përfshirë në projekte të veçanta të punës së dobishme shoqërore të realizuara në vitin e kaluar shkollor
- preferencave të mësuesve përgjegjës

Në listën e llojeve të ofruara të punës së dobishme shoqërore nga të cilat pritet që nxënësit të bëjnë zgjedhjen e tyre, duhet të përmenden si vijon:

- Lloji i punës së dobishme shoqërore dhe grupi i synuar të cilit i referohet
- Mësimdhënësi përgjegjës për realizimin e saj

- Periudha kohore e realizimit të saj dhe mënyra se si pritet të realizohet (pas/para orëve të mësimimit, të shtunave etj.).
- Efektet që pritet të arrihen në komunitet dhe rezultatet e pritura të të nxënimit për nxënësit

Çdo nxënës nga secila klasë bën zgjedhjen në atë mënyrë që në listë shënon (me 1 dhe 2) dy lloje të punës së dobishme shoqërore në të cilat do të dëshironte të merrte pjesë, me 1 shënën llojin e punës që është zgjedhja e tij e parë, dhe me 2 atë që është zgjedhja e tij e dytë. Kjo gjë mundëson që mësimitdhënësit/ shkolla t'i shpërndaj projektet për punën e dobishme shoqërore në gjysmëvjetor dhe të ndajë nxënësit në grupe. Gjatë formimit të grupeve, përparësi ka zgjedhja e parë, ndërsa zgjedhja e dytë merret parasysht nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve të interesuar për të formuar një grup.

Procedura përsëritet çdo vit shkollor. Gjatë kësaj, duhet pasur parasysht se një nxënës nuk mund të zgjedhë të njëjtën punë të dobishme shoqërore në disa vite shkollore, por përkundrazi, duhet të përfshihet në një lloj tjetër pune në çdo vit shkollor. Prandaj, rekomandohet që lista e llojeve të ofruara të punëve të dobishme shoqërore të modifikohet nga një vit shkollor në tjetrin në mënyrë që t'u ofrohet nxënësve mundësi më e madhe për të zgjedhur.

Grupet për realizimin e llojeve të përzgjedhura të punës së dobishme shoqërore formohen pas përfundimit të trajnimit për mësim teorik në të cilin marrin pjesë të gjithë nxënësit (pavarësisht grupit të cilit do t'i përkasin) dhe procedurës së përzgjedhjes të punës së dobishme shoqërore. Secili grup duhet të përbëhet nga më së shumti 20 nxënës, mundësisht me të njëjtin/përafërsisht numër të djemëve dhe vajzave. Gjatë caktimit të nxënësve në grupe, sipas përzgjedhjes së tyre, duhet të merret parasysht se grupi ose grupet për realizimin e një lloji të caktuar të punës së dobishme shoqërore mund të përbëhen nga nxënës të së njëjtës paralele ose nga nxënës të paraleleve të ndryshme të të njëjtit vit. Mësimitdhënësit përgjegjës pregatisin listë të nxënësve për çdo grup të veçantë, i informojnë nxënësit se në cilin grup janë caktuar dhe i publikojnë listat në web faqen e shkollës dhe/ose në tabelën e njoftimeve të shkollës.

Në shkollat ku mësimi zhvillohet në dy ose tre gjuhë, është e dëshirueshme që nxënësit që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore dhe kanë zgjedhur të njëjtën lloj pune të dobishme shoqërore, të formohen grupe "të përziera" nxënësish të balacuara në aspektin gjuhësor. Në rast të tillë, përgjegjës për zbatimin e projekteve me grupe të "përziera" nxënësish janë të paktën dy mësues (nga një për secilën gjuhë të përfaqësuar mësimore), të cilët i drejtojnë aktivitetet në dy gjuhë, me trajtim të barabartë të dy gjuhëve të përfaqësuara mësimore ndaj të gjithë nxënësve të përfshirë.

Në shkollat ku mësojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, formohen grupe të përziera në të cilat nxënësit me aftësi të kufizuara punojnë së bashku me bashkëmoshatarët e tyre për të mundësuar mbështetjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e përvojave. Krijimi i grupeve heterogjene i inkurajon bashkëmoshatarët të lidhen dhe të punojnë bashkarishtë mbi qëllimet e projektit. Është e rëndësishme të kultivohet mjedis barazie, në të cilin të gjithë nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur.

Nëse për një lloj pune të dobishme shoqërore paraqitet një numër i madh nxënësish shfaqet nevoja për të formuar disa grupe, bëhet shpërndarja e kohës së realizimit të projekteve, kështu që një pjesë e grupeve punojnë në gjysmëvjetorin e parë, e disa në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor.

## UDHËZIMET PËR ZBATIM

Ecuria e suksesshme e punës së dobishme shoqërore kërkon planifikim dhe koordinim të kujdesshëm, por edhe fleksibilitet që do të sigurojë përshtatjen me nevojat e nxënësve dhe të komunitetit. Udhëzimet e mëposhtme të zbatimit ofrojnë qasje hap pas hapi për Mësimdhënësit përgjegjës, shërbimin profesional dhe komunitetin e shkollës për të siguruar efektivitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e programit:

### I. Trajnime për mësim teorik (3 orë)

Trajnimet, që zgjasin 6 orë mësimore, organizohen për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga projektet për të cilat ata janë përcaktuar dhe i referohen koncepteve bazike të punës së dobishme shoqërore si: çështjet sociale globale dhe lokale, etika dhe përgjegjësia sociale dhe kompetenca kulturore (e shpjeguar në detaje tek Komponentat e punës së dobishme shoqërore). Gjatë kësaj duhet pasur kujdes si vijon:

#### Seanca interaktive:

- Përdorimi i një sërë metodash mësimdhënëse, duke përfshirë leksione, diskutime, prezantime multimediale dhe folës të ftuar, për të siguruar kuptimin e koncepteve bazë.
- Nxitja e pjesëmarrjes aktive të nxënësve duke parashtruar pyetje për diskutime në grup dhe të hapura për të thelluar të kuptuarit e tyre dhe për të stimuluar të menduarit kritik.

#### Përdorimi i rasteve të studimit:

- Prezantohen raste të studimit të jetës reale që pasqyrojnë çështje aktuale sociale dhe humanitare, ku nxënësit inkurajohen të analizojnë këto raste dhe të diskutojnë zgjidhjet e mundshme.
- Përmbajtja teorike lidhet me përvojat e nxënësve dhe me ngjarjet në komunitetet e tyre.

#### Kontrollim nëse konceptet bazë janë kuptuar:

- Përdoren kuize, teste të shkurtra dhe/ose prezantime në grup për të përcaktuar se sa nxënësit i kanë kuptuar konceptet bazë.
- Nxënësve u jepen informacione kthyesë për t'i ndihmuar të kuptojnë konceptet në mënyrë më efektive.

### II. Trajnime tematike (3 orë)

Trajnime tematik (i shpjeguar më hollësisht në kuadër të Komponentave të punës së dobishme shoqërore) relizohet për nevojat e një projekti konkret dhe mund të ndryshojë në kohëzgjatje, në varësi të faktit nëse (dhe sa) mësimdhënia e rregullt në vitet e mëparshme u ka mundësuar nxënësve të fitojnë kompetencat e nevojshme për realizimin e projektit. Në varësi të përmbajtjes së trajnimit, për realizimin e tij mund të angazhohen mësimdhënësi përgjegjës, mësimdhënësit tjetër, bashkëpunëtor profesional i shkollës, prind-vullnetar ose person-vullnetar.

### III. Planifikimi i projekteve (4 orë)

Planifikimi i realizimit të projektit në kornizën kohore të dhënë paraprakisht bëhet nga nxënësit të cilët janë përcaktuar për projektin e caktuar –planifikimi bëhet në grup. Mësimdhënësi përgjegjës ka rolin e mbikëqyrjes së planifikimit për të siguruar që planifikimi të mos

komprometojë parimet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes dhe të sigurojë përfshirjen e të gjithë nxënësve në grup. Planifikimi përfshin:

#### **Përcaktimin e aktiviteteve**

- Nxënësit, në kuadër të grupit të tyre dhe me ndihmën e mësimitdhënësit përgjegjës, i përcaktojnë aktivitetet për realizimin e projektit, të cilat mund të organizohen si hapa që rrjedhin njëri pas tjetrit ose si aktivitete të pavarura, të cilat mund të realizohen paralelisht (nga nën-grupe të vogla) ose njëra pas tjetrës, sipas një renditjeje të përcaktuar. Vëmendje e veçantë i kushtohet përcaktimit dhe përshtatjes së aktiviteteve me mundësitë dhe interesat e nxënësve me aftësi të kufizuara.

#### **Përgatitjen e planit aksional**

- Shërben si udhëzues për organizimin dhe zbatimin me sukses të punës së dobishme shoqërore, duke ofruar strukturë, detyra dhe qëllime të qarta.
- Formulohet në formën e tabelës në të cilën renditen (formulari është dhënë në Shtojcën B):
  - aktivitetet konkrete të cilat duhet të ndërmerren
  - përshkrim i shkurtër i secilit prej aktiviteteve
  - periudha kohore/afatet kohore për realizimin e secilit aktivitet
  - emri i nxënësi i cili është përgjegjës për zbatimin e secilit prej aktiviteteve
  - emrat e nxënësve të përfshirë në realizimin e çdo aktiviteti
  - burimet (materialet, mjetet dhe/ose veglat) për zbatimin e secilit aktivitet
  - rezultatet e pritura (të matshme dhe/ose të dukshme) nga secili aktivitet

#### **Sigurimin e burimeve për realizimin e projektit**

- Nxënësit, me ndihmën e mësimitdhënësit, sigurojnë burimet (mjetet, materialet dhe/ose veglat) e nevojshme për realizimin e projektit përpara se të fillojë zbatimi i tij.
- Nëse lista e burimeve të nevojshme është e gjatë dhe/ose shkolla nuk disponon disa prej burimeve, sigurimi i tyre mund të bëhet aktivitet i veçantë brenda projektit dhe si i tillë, të renditet në planin aksional. Në një rast të tillë, sigurimi i burimeve (ose një pjesë e tyre) bëhet pjesë e implementimit të projektit.

## **IV. Zbatimi i projekteve (20 orë)**

Zbatimi i çdo projekti ndjek dinamikën e vet, të përcaktuar me planin aksional. Mësimitdhënësi është përgjegjës për motivimin e nxënësve dhe realizimin me sukses të çdo aktiviteti të përshkruar në plan. Për këtë qëllim, është thelbësore të sigurohet:

#### **Ndjekja dhe mbështetja e zbatimit:**

- Mësimitdhënësi përgjegjës duhet të ndjek rregullisht punën dhe ecurinë e grupit "të tij" dhe të ofrojë udhëzime për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë realizimit të aktiviteteve. Mësimitdhënësi duhet t'u ofrojë mbështetje nxënësve me aftësi të kufizuara kur ata kanë nevojë dhe u jep udhëzime të qarta dhe i inkurajon rregullisht.
- Në fokus të ndjekjes së punës së projektit janë rezultatet e pritshme (të matshme dhe/ose të dukshme) të secilit aktivitet të përcaktuar nga plani aksional. Detyra e Mësimitdhënësit përgjegjës është, së bashku me nxënësit e grupit, të konstatojë nëse (dhe në çfarë mase) janë arritur rezultatet e pritura të planifikuara dhe, nëse është e nevojshme, të parashikojë masa që duhen marrë për realizimin e plotë të tyre.

- Mësimdhënësi përgjegjës siguron që projektet të realizohen në mënyrë të sigurt dhe etike, veçanërisht kur aktivitetet janë të përqendruara te grupet e cënueshme dhe/ose çështjet e ndjeshme.

#### **Dokumentimi i përvojave të nxënësve:**

- Prej nxënësve pritet që gjatë realizimit të aktiviteteve të dokumentojnë përvojat e tyre, sfidat dhe momentet e të nxënësve, duke mbajtur ditar (në formë elektronike ose të shkruar) në të cilin do të shënojnë mendimet, pikpamjet dhe emocionet e tyre të ilustruara me fotografi (nëse paraprakisht kanë marrë pëlqim për fotografim).

## **V. Reflektimi mbi punën (2 orë)**

### **Seancë reflektuese**

- Pas përfundimit të projekteve të tyre, nxënësit nga grupi marrin pjesë në një seancë reflektuese ku ndajnë përvojat e tyre, sfidat me të cilat janë përballur dhe sukseset që kanë arritur.
- Nxënësit marrin informacione kthyes nga mësimdhënësi përgjegjës, eventualisht dhe nga përfaqësuesi i grupit të synuar (ose personi përgjegjës për grupin e synuar) të cilat synojnë t'i ndihmojnë ata të vlerësojnë në mënyrë kritike punën e tyre dhe efektet e saj.
- Pas përfundimit të projekteve, të gjithë nxënësit duhet të vlerësohen për punën e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për nxitjen e vetëbesimit të nxënësve me aftësi të kufizuara.

### **Diskutim për angazhim të ardhshëm**

Nga reflektimi duhet të dalin ide për përfshirjen e mëtejshme të nxënësve në aktivitete dhe iniciativa me dobi shoqërore. Nxënësit nxiten të mendojnë se si njohuritë, shkathësitë dhe përvojat e fituara mund t'i zbatojnë në projekte të ardhshme shkollore, aktivitete vullnetare, iniciativa rinore dhe forma të tjera të pjesëmarrjes aktive qytetare. Në këtë mënyrë, puna me dobi shoqërore nuk përfundon me realizimin e projektit konkret, por shërben si nxitje për zhvillimin e një kulture të qëndrueshme të përgjegjësisë, solidaritetit, vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive në komunitet.

## **VI. Promovimi i projekteve (4 orë)**

Puna për secilin projekt përfundon me ngjarje ku prezantohen përpjekjet dhe arritjet e nxënësve. Pritet që në të njëjtën ngjarje të promovohen të gjitha projektet e realizuara në vitin rrjedhës shkollor ose të organizohen disa ngjarje dhe në secilin prej tyre të promovohen projekte të të njëjtit lloj të punës së dobishme shoqërore. Në ngjarje duhet të marrin pjesë përfaqësues të menaxhmentit të shkollës dhe mësues, prindër/kujdestarë dhe përfaqësues të grupeve të synuara dhe komuniteteve. Ngjarja duhet të përfshijë:

### **Prezantime përfundimtare**

- Secili grup prezanton projektin e tij përmes një prezantimi (multimedial, videoklip, fotografi, prezantim power point) të aktiviteteve që ka ndërmarrë dhe rezultateve që ka arritur, duke theksuar ndikimin që ka bërë dhe sfidat që ka kapërcyer.

- Prezantimet u mundësojnë nxënësve pjesëmarrës të prezantojnë punën e tyre, ndërsa nxënësve të tjerë të mësojnë nga përvojat e bashkëmoshatarëve të tyre.

#### **Festë për arritjet**

- Ngjarja paraqet " festim" të punës dhe kontributit të nxënësve që kanë punuar në projekte të ndryshme.
- Në festë të gjithë pjesëmarrësve në projektet e paraqitura në ngjarje u ndahen certifikata, ndërsa nxënësve që janë dalluar veçanërisht me pjesëmarrjen e tyre u ndahen edhe mirënjohje për përpjekjet e tyre për të bërë ndryshim pozitiv në komunitetet e tyre.

## **VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Mësimdhënësit përgjegjës për realizimin e punës së dobishme shoqërore duhet të ndjekin vazhdimisht pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve në projekte dhe të vlerësojnë progresin e secilit nxënës të përfshirë. Para fillimit të realizimit të projekteve, mësimdhënësit duhet të planifikojnë edhe mënyrën e ndjekjes së arritjeve të nxënësve. Gjatë realizimit të aktiviteteve të projekteve të punës së dobishme shoqërore, nga çdo mësimdhënës përgjegjës pritet:

- të ndjek dhe shënojë rregullsinë e secilit nxënës,
- të ndjek angazhimin e çdo nxënësi gjatë kohës së aktiviteteve, përkushtimin dhe kontributin që ai ka në realizimin e tyre;
- të kontrolloj ditarët e nxënësve në të cilët ata shënojnë mendimet, pikpamjet dhe emocionet e tyre në lidhje me aktivitetet që kryejnë në mënyrë që të fitojë njohuri mbi përkushtimin e tyre dhe efektet nga puna e dobishme shoqërore në zhvillimin e tyre personal dhe
- të vlerësojë përparimin e çdo nxënësi në përvetësimin e njohurive (sa informata të reja përftohen përmes përvojës), në përvetësimin e aftësive (zgjidhja e problemeve, komunikimi, udhëheqja dhe bashkëpunimi) në manifestimin e vlerave të nevojshme (përgjegjësia, qëndrueshmëria, motivimi etj.) si dhe kontributi në realizimin e aktiviteteve (arritja e qëllimeve, respektimi i afateve etj.).

Vlerësimi i pjesëmarrjes në punën e dobishme shoqërore bëhet në mënyrë përkrahëse, me fokus në angazhimin, përpjekjen e investuar dhe përparimin e nxënësit, e jo vetëm në numrin e orëve të realizuara të punës së dobishme shoqërore. Kategoritë ose nivelet përkrahëse të arritjeve, të cilat pasqyrojnë shkallën e ndryshme të suksesit dhe angazhimit të nxënësit në punën e dobishme shoqërore, janë si vijon:

- **Pjesëmarrje e jashtëzakonshme**  
Shembull: „Nxënësi ka demonstruar vazhdimisht entuziazëm, iniciativë dhe udhëheqje të jashtëzakonshme në të gjitha aktivitetet. Ai gjithashtu ka treguar përkushtim të thellë për të bërë ndikim pozitiv në komunitet dhe me pjesëmarrjen dhe punën e tij i tejkaloi pritshmëritë e përcaktuara me planin aksional.”
- **Pjesëmarrje e angazhuar**  
Shembull: „Nxënësja u angazhua plotësisht në realizimin e detyrave, duke demonstruar siguri dhe etikë të fortë pune. Kontribuoi ndjeshëm në punën praktike të ekipit dhe iu qas të gjitha aktiviteteve me përgjegjësi dhe me qëndrim pozitiv.”

- **Pjesëmarrje e kënaqshme**

Shembull: „Nxënësja investoi nivel të kënaqshëm pune dhe tregoi gatishmëri për të bashkëpunuar në kryerjen e detyrave, por i mungonte iniciativa dhe kreativiteti për të përmbushur të gjitha pritshmëritë.“

- **Përmirësimi i nevojshëm**

Shembull: „Pjesëmarrja e nxënësit ishte minimale. Ai ka potencial, por duhet të fokusohet në punën ekipore, të tregojë më shumë përgjegjësi dhe të bëjë më shumë përpjekje për të kontribuar në realizimin e detyrave.“

Nota përshkruese për punën e dobishme shoqërore shënohet në dëftesën shtesë të nxënësit.

### A. Shembuj të projekteve

Shembujt e mëposhtëm të projekteve synojnë të shërbejnë si frymëzim për realizimin e punës të dobishme shoqërore dhe jo si modele për realizim.

---

#### **Aksion pastrimi në komunitet:**

Përfshirja e nxënësve në aksione pastrimi në komunitet, me qëllim zhvillimin e përgjegjësisë ndaj mjedisit jetësor.

##### 1. **Temat e trajnimit:**

- Rëndësia e sigurimit të higjienës në hapësirat publike
- Roli i qytetarëve dhe shërbimeve në mbajtjen e higjienës në hapësirat publike
- Llojet e mbeturinave dhe menaxhimi me mbeturinat
- Përdorimi i sigurt i materialeve dhe pajisjeve të pastrimit

##### 2. **Planifikimi:**

- Identifikimi i zonës lokale në të cilin ka nevojë për pastrim (p.sh. park, zona përreth lumit, plazh, lagje ose të tjera).
- Përgatitja e hulumtimit për shkaqet e hedhjes së mbeturinave në atë zonë (kush hedh, nëse ka mjaft kosha mbeturinash dhe sa ka, sa rregullisht të njëjtat zbrazen).
- Bashkëpunimi me autoritetet lokale ose grupet në komunitet në planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta të projektit.
- Caktimi i roleve të nxënësve (p.sh. udhëheqësit e ekipeve, koordinatorët logjistikë, personat për komunikim).

##### 3. **Zbatimi:**

- Zbatimi i hulumtimit dhe përpunimi i të dhënave
- Pajisja e nxënësve me mjetet dhe pajisjet e nevojshme (doreza, fshesa, thasë plehrash, jelekë mbrojtës).
- Ndarja e hapësirës në pjesë dhe përcaktimi i grupeve të nxënësve për të pastruar secilën pjesë.
- Pastrimi i zonave të caktuara në bashkëpunim me shërbimet lokale, klasifikimi i mbeturinave për riciklim aty ku është i mundur.

##### 4. **Pyetje për reflektim:**

- Cili ishte roli juaj gjatë fushatës së pastrimit?
- Me çfarë sfidash u përballët? Si i tejkaluat ato?
- Çfarë keni mësuar për përgjegjësinë ekologjike?
- Si ndikoi kjo përvojë në pikëpamjet tuaja për punën e dobishme shoqërore?

### ***Vizitë në institucion për përkujdesjeje për personat e moshuar***

Nxitja e lidhjeve dhe ndjeshmërisë midis gjeneratave duke organizuar vizita në institucion për përkujdesjeje për personat e moshuar.

#### **1. Temat e trajnimit:**

- Kuptimi i plakjes dhe nevojave të personave të moshuar
- Komunikimi efektiv me personat e moshuar
- Respektimi i privatësisë dhe dinjitetit të personave të moshuar
- Aktivitete për të mbushur kohën e lirë të personave të moshuar

#### **2. Planifikimi:**

- Përgatije e nxënësve për të respektuar gjeneratat e vjetra.
- Kontaktimi me institucionin lokal të kujdesit për personat e moshuar për të organizuar vizitë.
- Planifikimi i aktiviteteve të tilla si leximi, luajtja e lojërave ose thjesht biseda me banuesit e atij institucioni.

#### **3. Zbatimi:**

- Organizimi i vizitave pasi të sigurohet se nxënësit janë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Sigurimi i ndërveprimeve ndërmjet nxënësve dhe banuesve në të cilat të gjithë ndajnë historitë dhe përvojat e jetës.

#### **4. Pyetje për reflektim:**

- Si u ndjetë para dhe pas vizitës?
- Çfarë mësuat nga bashkëveprimi me banuesit?
- Çfarë ju befasoi gjatë vizitës suaj?
- Si mund të vazhdoni të mbështesni të moshuarit në komunitetin tuaj?

---

### ***Mbledhja e fondeve për qëllime humanitare***

Përfshirja e nxënësve në mbledhjen e fondeve për një qëllim të zgjedhur duke organizuar një ngjarje humanitare.

#### **1. Temat e trajnimit:**

- Planifikimi dhe organizimi i ngjarjeve humanitare
- Negocim me sponsorë dhe donatorë
- Përdorimi i mediave sociale për qëllime marketingu
- Parimet etike gjatë mbledhjes së fondeve për qëllime humanitare

#### **2. Planifikimi:**

- Identifikimi i nevojave dhe/ ose një organizate bamirësie për ndihmë dhe mbështetje (p.sh. Kryqi i Kuq, strehimorja e kafshëve, spitali i fëmijëve).
- Mbledhja e ideve për organizim të një ngjarjeje për mbledhjen e fondeve (p.sh. "mbrëmje vallëzimi" me grupin e shkollës, aktivitet bamirësie, shfaqje talentesh) dhe përzgjedhja e ides për realizim.
- Planifikimi i ngjarjes.
- Krijimi i buxhetit për organizimin e ngjarjes.

#### **3. Zbatimi:**

- Realizimi i ngjarjes nga nxënësit të cilët janë të ndarë në grupe më të vogla përgjegjëse për promovim, shitje, mbështetje logjistike etj.
- Përfshirja e pjesëmarrësve në ngjarje të cilët nuk vijnë nga shkolla.

#### **4. Pyetje për reflektim:**

- Pse zgjodhët këtë kauzë të veçantë për të mbështetur?
- Çfarë roli keni pasur në organizimin e ngjarjes?
- Cila ishte pjesa më e vlefshme e përvojës?

- Si ndikoi ngjarja në të kuptuarit tuaj për punën e dobishm shiqërore?
- 

### ***Programi për tutorë me bashkëmoshatarët***

Promovimi i suksesit akademik dhe mentorimi duke krijuar program tutorimi ndërmjet nxënësve në shkollë.

#### **1. Temat e trajnimit:**

- Çfarë është tutorimi dhe pse është i rëndësishëm?
- Krijimi i planeve efektive të mësimit
- Etika dhe konfidencialiteti në tutorim
- Bashkëpunimi me mësime dhënësit
- Menaxhimi i kohës dhe organizimi

#### **2. Planifikimi:**

- Identifikimi i nxënësve të cilët kanë nevojë për mbështetje akademike dhe atyre që mund të shërbejnë si tutorë.
- Lidhja e nxënësve të tutoruar me tutorë bazuar në nevojat e nxënësve të tutoruar.
- Përgatitja e orarit për sesionet tutoriale dhe hapësirës ku mund të mbahen ato.

#### **3. Zbatimi:**

- Trajnimi i bashkëmoshatarëve për metodat efektive të tutorimit dhe aftësitë e komunikimit.
- Ndjekja e progresit të sesioneve të tutorimit dhe sigurimi i mbështetjes shtesë sipas nevojave.

#### **4. Pyetje për reflektim:**

- Tutorët: Çfarë keni mësuar nga dhënia e ndihmës kundrejt bashkëmoshatarëve tuaj?
  - Të tutoruarit: Si ju ka ndihmuar tutorimi në mësimin tuaj?
  - Me çfarë sfidash jeni ballafaquar dhe si i keni kaluar ato?
  - Si mund të përmirësohet ky program për pjesëmarrësit e ardhshëm?
- 

### ***Fushatë për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën e bashkëmoshatarëve***

Rritja e ndërgjegjësimit për pasojat e dëmshme të dhunës së bashkëmoshatarëve përmes organizimit të një fushate në nivel shkolle dhe/ose komuniteti.

#### **1. Temat e trajnimit:**

- Llojet e dhunës së bashkëmoshatarëve
- Pasojat e dhunës së bashkëmoshatarëve
- Roli i shokëve të klasës në parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave nga dhuna e bashkëmoshatarëve
- Planifikimi i fushatës për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën e bashkëmoshatarëve
- Përdorimi i përgjegjshëm i mediave sociale në fushatat ndërgjegjësuere

#### **2. Planifikimi:**

- Zgjedhja e llojit të fushatës (punëtori me bashkëmoshatarë, postera, fletushka dhe/ose pllakata, mesazhe në rrjetet sociale, shfaqje teatrale, shfaqje muzikore ose ekspozita arti, etj.)
- Zhvillimi i një strategjie për drejtimin e fushatës për të arritur efekte maksimale.
- Caktimi i roleve të nxënësve përgjatë fushatës (p.sh., krijuesit e përmbajtjeve, prezantuesit, organizatorët, promovuesit mediatik, etj.)

#### **3. Zbatimi:**

- Fillimi i fushatës duke përdorur platforma të ndryshme për promovim.
- Përgatitja e përmbajtjes për fushatën
- Organizimi i ngjarjeve për promovimin e përmbajtjeve

4. **Pyetje për reflektim:**

- Përse e keni të rëndësishme këtë çështje?
  - Si ndikoi fushata në të kuptuarit tuaj të problemit?
  - Cila ishte pjesa më efektive e fushatës?
  - Çfarë do të bënit ndryshe nëse do ta drejtonit sërish këtë fushatë?
-

## B. Formular për planifikim të projekti

|                                 |                          |
|---------------------------------|--------------------------|
| Titulli i projektit             |                          |
| Qëllimet e projektit            |                          |
| Mësimdhënës përgjegjës          |                          |
| Nxënësit-pjesëmarrës në projekt | 1.<br>2.<br>3.<br>:<br>: |

| Aktiviteti | Përshkrimi i aktivitetit | Afati i realizimit (nga... deri ...) | Emri i nxënësit/ nxënësve përgjegjës | Emrat e nxënësve të përfshirë | Burimet e nevojshme | Rezultatet e pritshme |
|------------|--------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------|---------------------|-----------------------|
| 1.         |                          |                                      |                                      |                               |                     |                       |
| 2.         |                          |                                      |                                      |                               |                     |                       |
| 3.         |                          |                                      |                                      |                               |                     |                       |
| 4.         |                          |                                      |                                      |                               |                     |                       |
| ...        |                          |                                      |                                      |                               |                     |                       |